



UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA
RAPORT I VLERËSIMIT TË INSTITUCIONIT
NGA STAFI AKADEMIK
VITI AKADEMIK 2025–2026

Institucioni	: Universiteti Metropolitan Tirana
Njësia përgjegjëse	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)
Periudha kohore	: 01 – 12 qershor 2026
Metoda e plotësimit	: Online – Edu4School
Numri i pjesëmarrësve	: 44
Përgatiti	: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
Data e publikimit	: 30 qershor, 2026

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Metodologjia.....	3
Përbërja e NJSBC për vitin akademik 2025-2026.....	4
Profili i pjesëmarrësve në pyetësor.....	5
I. Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit.....	5
II. Roli, të drejtat dhe angazhimi i personelit akademik.....	7
III. Shërbimet dhe mbështetja akademike e institucionit.....	9
IV. Vizioni dhe strategjia institucionale.....	12
Aspektet që i japin kënaqësi stafit akademik në punën në UMT.....	14
Sugjerime të stafit për zhvillimin e mëtejshëm të mjedisit akademik dhe institucional.....	15
Përfundime.....	16

Hyrje

Ky raport paraqet rezultatet e vlerësimit të Universitetit Metropolitan Tirana (UMT) nga personeli akademik për vitin akademik 2025–2026. Vlerësimi është pjesë e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe është administruar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC).

Qëllimi i raportit është të evidentojë perceptimet e stafit akademik mbi kushtet e punës, funksionimin e proceseve institucionale, mbështetjen administrative dhe akademike, si edhe orientimin strategjik të institucionit. Rezultatet ofrojnë një pasqyrë të përvojës së stafit në marrëdhënien e tij me institucionin dhe shërbejnë për të identifikuar elementet që vlerësohen më pozitivisht, si edhe çështjet që mund të trajtohen në vijim.

Raporti kombinon të dhënat sasiore të pyetësorit me komentet e hapura të pjesëmarrësve. Kjo qasje mundëson një lexim më të plotë të vlerësimeve, sugjerimeve dhe shqetësimeve të stafit lidhur me mjedisin e punës, zhvillimin profesional dhe administrimin institucional.

Dokumenti synon t'u shërbejë strukturave drejtuese dhe njësive përkatëse si bazë për reflektim, vendimmarrje dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë institucionale.

Metodologjia

Vlerësimi i institucionit nga personeli akademik për vitin akademik 2025–2026 u realizua përmes një pyetësi online, të administruar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC). Pyetësi u zhvillua në periudhën 1–12 qershor 2026 dhe iu dërgua të gjithë stafit akademik përmes platformës Edu4School. Pjesëmarrja ishte vullnetare dhe plotësimi i pyetësit u krye në mënyrë anonime, me synim garantimin e lirisë së shprehjes dhe mbledhjen e perceptimeve sa më të sinqerta mbi funksionimin e institucionit.

Instrumenti përmbante pyetje të mbyllura dhe pyetje të hapura. Pyetjet e mbyllura u organizuan në katër fusha: infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit; roli, të drejtat dhe angazhimi i personelit akademik; shërbimet dhe mbështetja akademike; si edhe vizioni dhe strategjia institucionale. Vlerësimi i indikatorëve u realizua përmes një shkalle pesëpikëshe, ku vlera 1

shprehte vlerësimin më të ulët, ndërsa vlera 5 vlerësimin më të lartë.

Në përfundim të periudhës së administrimit, pyetësi u plotësua nga 44 anëtarë të stafit akademik. Të dhënat u përpunuan dhe u analizuan në programin statistikor SPSS. Për secilin indikator u përdorën statistika përshkruese, përfshirë numrin e përgjigjeve të vlefshme (*N*), vlerën minimale dhe maksimale, mesataren aritmetike (*Mean*) dhe devijimin standard (*Std. Deviation*). Mesatarja u përdor për të paraqitur nivelin e vlerësimit për secilin indikator, ndërsa devijimi standard për të evidentuar shkallën e njëtrajtshmërisë ose ndryshueshmërisë së përgjigjeve.

Rezultatet interpretohen si pasqyrim i perceptimeve të stafit akademik pjesëmarrës në pyetësor.

Interpretimi i rezultateve është bazuar në krahasimin e vlerave mesatare të secilit indikator dhe në shqyrtimin e shpërndarjes së përgjigjeve. Analiza eidenton perceptimet e stafit për aspektet e ndryshme të funksionimit institucional, duke nxjerrë në pah elementet që marrin vlerësime më të larta dhe ato që shfaqin vlerësime më të moderuara.

Pyetjet e hapura janë pjesë përbërëse e raportit dhe analizohen përmes grupimit tematik të komenteve të stafit. Ky interpretim cilësor plotëson të dhënat sasiore, duke evidentuar vlerësimet, shqetësimet dhe sugjerimet e shprehura nga pjesëmarrësit.

Përbërja e NJSBC për vitin akademik 2025-2026

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtarë, nga të cilët 3 (tre) janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues nga administrata, 1 (një) ekspert i jashtëm dhe 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor. Kryetari dhe anëtarët e njësisë janë miratuar nga Senati Akademik me propozim të Rektorit.

Nr	Emri Mbiemri	Funksioni	Përfaqësimi
1	Dr.Marsida Gorea	Kryetare	Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës
2	Dr.Almarin Frakulli	Anëtar	Fakulteti i Ekonomisë
3	MSc. Virtyt Lesha	Anëtar	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT
4	MSc Albina Joga	Anëtare	Administrata
5	Prof.Asoc.Dr. Ramadan Çipuri	Anëtar	Ekspert i jashtëm
6	Anja Balliu	Anëtare	Përfaqësuese e studentëve

Profili i pjesëmarrësve në pyetësor

Pyetësi u plotësua nga **44 anëtarë të stafit akademik**. Pjesëmarrja përfshin të tri kategoritë akademike: lektorë (47.7%), profesorë (27.3%) dhe asistent-lektorë (25.0%). Kjo shpërndarje siguron përfaqësim të balancuar të kategorive kryesore të stafit në analizën e rezultateve.

Tabela 1 Shpërndarja e stafit akademik pjesëmarrës sipas kategorisë akademike

Kategoria së cilës i përkisni					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Lektor	21	47.7	47.7	47.7
	Profesor	12	27.3	27.3	75.0
	Asistent lektor	11	25.0	25.0	100.0
	Total	44	100.0	100.0	

Pjesëmarrësit përfaqësojnë nivele të ndryshme të përvojës profesionale. Grupet më të përfaqësuara janë pedagogët me 11–15 vjet dhe ata me mbi 20 vjet përvojë, me nga 25.0% secili. Në tërësi, të dhënat përfshijnë si staf në fazat e para të karrierës, ashtu edhe staf me përvojë të konsoliduar, duke mundësuar një pasqyrim më të gjerë të perceptimeve mbi institucionin.

Tabela 2 Shpërndarja e stafit akademik pjesëmarrës sipas përvojës në punë

Eksperiencia e punës					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	A. 1-5 vjet	10	22.7	22.7	22.7
	B. 6-10 vjet	6	13.6	13.6	36.4
	C. 11-15 vjet	11	25.0	25.0	61.4
	D. 16-20 vjet	6	13.6	13.6	75.0
	E. Mbi 20 vjet	11	25.0	25.0	100.0
	Total	44	100.0	100.0	

I. Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit

Të dhënat tregojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv për infrastrukturën fizike dhe teknologjike të institucionit. Të gjithë indikatorët kanë mesatare mbi nivelin 3.80, çka sugjeron se stafi akademik e percepton këtë dimension si funksional dhe mbështetës për zhvillimin normal të punës

akademike.

Tabela 3 Vlerësimi i stafit akademik për infrastrukturën fizike dhe teknologjike të institucionit

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës	44	2	5	4.39	.784
Jam i kënaqur me nivelin e sigurisë fizike dhe të mbrojtjes që institucioni ofron	44	2	5	4.50	.792
Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë e ofruar në institucion janë në nivelin e duhur	44	2	5	3.84	.914
Hapësira që kam në vendin e punës dhe mësimdhënies është e mjaftueshme dhe motivuese për punë efektive	44	2	5	3.84	.776
Institucioni ofron një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore (si projektorë, kompjuterë, rrjet interneti, sistem i menaxhimit të informacionit) që lehtëson mësimdhënien dhe kërkimin	44	3	5	4.20	.509
Numri i studentëve në klasa lejon zhvillimin normal dhe efektiv të mësimin	44	3	5	4.48	.731
Valid N (listwise)	44				

Vlerësimi më i lartë lidhet me **sigurinë fizike dhe mbrojtjen që ofron institucioni** ($M = 4.50$). Ky rezultat tregon një nivel të lartë besimi të stafit ndaj kushteve të sigurisë në mjediset universitare.

Po ashtu, **numri i studentëve në klasa** vlerësohet shumë pozitivisht ($M = 4.48$). Kjo tregon se, sipas stafit akademik, madhësia e grupeve mësimore lejon zhvillimin normal dhe efektiv të procesit të mësimdhënies.

Edhe **pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta** marrin një vlerësim të lartë ($M =$

4.39). Ky indikator dëshmon se standardet e higjienës dhe mirëmbajtjes perceptohen si të qëndrueshme dhe të përshtatshme.

Infrastruktura teknologjike vlerësohet në nivel të lartë ($M = 4.20$). Devijimi standard i ulët ($SD = .509$) tregon një perceptim relativisht të njëtrajtshëm pozitiv nga stafi akademik për pajisjet dhe shërbimet teknologjike që mbështesin mësimdhënien dhe kërkimin.

Vlerësime disi më të moderuara marrin **shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë** ($M = 3.84$) dhe **hapësira në vendin e punës dhe mësimdhënies** ($M = 3.84$). Këto rezultate mbeten pozitive, por janë më të ulëta brenda këtij dimension. *Për këtë arsye, ato mund të konsiderohen si fusha ku institucioni mund të ndërhyjë me masa përmirësuese, sidomos për ta bërë mjedisin e punës më komod, më motivues dhe më të mbështetur nga shërbime bazë funksionale.*

Rezultatet e këtij seksioni evidentojnë vlerësime të larta për kushtet fizike dhe teknologjike të institucionit. Shërbimet mjekësore dhe hapësirat e punës mund të mbeten në vëmendje si elemente që mund të konsolidohen më tej.

II. Roli, të drejtat dhe angazhimi i personelit akademik

Ky seksion vlerëson mënyrën se si stafi akademik e percepton qartësinë e rolit të tij, respektimin e të drejtave dhe kushteve të angazhimit, si edhe mundësitë për pjesëmarrje dhe zhvillim brenda institucionit. Rezultatet paraqesin një vlerësim përgjithësisht pozitiv për këtë dimension.

Tabela 4 Vlerësimi i stafit akademik për rolin, të drejtat dhe kushtet e angazhimit në institucion

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Kam përshkrim të qartë të detyrave që më përkasin	44	1	5	4.36	.990
Institucioni respekton kushtet kontraktuale lidhur me angazhimin tim	44	2	5	4.34	.776
Procedurat për adresimin e ankesave janë të aksesueshme	44	2	5	4.20	.851

Procesi i vlerësimit të performancës akademike është i qartë, transparent dhe i bazuar në kritere objektive	44	2	5	4.48	.664
Personeli akademik gëzon liri në shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tij	44	2	5	4.30	.878
Institucioni mbështet dhe inkurajon idetë dhe kontributet e reja nga personeli akademik	44	2	5	4.16	.805
Institucioni nxit përfshirjen e personelit akademik në proceset vendimmarrëse	44	2	5	3.82	.896
Detyrat e mia janë në përputhje me fushën time akademike	44	2	5	4.43	.873
Jam i kënaqur me balancën ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit	44	2	5	3.86	.979
Përfshirja ime në detyra administrative ndikon në kohën dhe energjinë që mund t'i përkushtoj angazhimeve akademike	44	2	5	3.82	1.018
Valid N (listwise)	44				

Vlerësimi më i lartë i këtij dimension i përket **procesit të vlerësimit të performancës akademike** ($M = 4.48$). Stafit e percepton këtë proces si të qartë, transparent dhe të mbështetur në kritere objektive.

Edhe **përputhja e detyrave me fushën akademike** vlerësohet shumë pozitivisht ($M = 4.43$). Ky rezultat sugjeron se angazhimet e stafit janë, në pjesën më të madhe, në harmoni me profilin dhe ekspertizën e tyre profesionale.

Qartësia e përshkrimit të detyrave ($M = 4.36$) dhe **respektimi i kushteve kontraktuale** ($M = 4.34$) marrin gjithashtu vlerësime të larta. Këto rezultate tregojnë se marrëdhënia e punës dhe përgjegjësitë kryesore profesionale perceptohen si të përcaktuara në mënyrë të kuptueshme.

Në të njëjtin nivel qëndron edhe **liria e stafit akademik për të shprehur mendime dhe qëndrime** ($M = 4.30$). Rezultati tregon se ekziston një perceptim pozitiv për hapësirën e nevojshme të shprehjes profesionale brenda institucionit.

Procedurat për adresimin e ankesave ($M = 4.20$) dhe **mbështetja për ide e kontribute të reja** ($M = 4.16$) vlerësohen në nivel të lartë. Kjo sugjeron se mekanizmat institucionalë për komunikim dhe iniciativa akademike janë të pranishëm dhe funksionalë në perceptimin e shumicës së stafit.

Vlerësime më të moderuara shfaqen për **balancën ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit** ($M = 3.86$), si edhe për **përfshirjen e stafit në proceset vendimmarrëse** ($M = 3.82$). *Këto aspekte, edhe pse në nivele të kënaqshme vlerësimi, mund të forcohen përmes konsultimeve më të rregullta dhe një organizimi më të balancuar të angazhimeve akademike.*

Përfshirja në detyra administrative vlerësohet me $M = 3.82$. Rezultati sugjeron se stafi e percepton këtë angazhim si përgjithësisht të menaxhueshëm, por *ruajtja e një ekuilibri të përshtatshëm me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin profesional mbetet e rëndësishme.*

Rezultatet e këtij seksioni pasqyrojnë një marrëdhënie pozitive të stafit me institucionin, të mbështetur në qartësinë e rolit, respektimin e kushteve të angazhimit dhe lirinë akademike. Aspektet që mund të vijnë të konsolidohen lidhen me përfshirjen e stafit në vendimmarrje, ruajtjen e balancës ndërmjet angazhimeve akademike dhe administrative, si edhe mbështetjen e vazhdueshme për iniciativat profesionale të stafit.

III. Shërbimet dhe mbështetja akademike e institucionit

Ky seksion shqyrton mbështetjen që institucioni i ofron stafit në punën e përditshme, zhvillimin profesional dhe veprimtarinë kërkimore, si edhe disa elemente të marrëdhënies akademike me studentët. Vlerësimet janë përgjithësisht të larta, me mesatare mbi 4.00 në shumicën e indikatorëve.

Tabela 5 Vlerësimi i stafit akademik për shërbimet administrative, mjedisin e punës dhe mbështetjen për zhvillimin akademik

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Institucioni më ofron mbështetjen administrative të nevojshme për përmbushjen e detyrave të mia	44	3	5	4.32	.639
Numri i personelit administrativ është i mjaftueshëm për të mbështetur nevojat e institucionit	44	2	5	4.27	.788
Jam i kënaqur me efektivitetin e punës së sekretarisë së njësive përkatëse	44	2	5	4.34	.914
Institucioni ofron një mjedis pune të qëndrueshëm dhe siguri për vazhdimësinë e angazhimit tim akademik	44	2	5	4.14	.930
Jam i kënaqur me atmosferën e përgjithshme të punës në institucion	44	2	5	4.34	.805
Kam një bashkëpunim konstruktiv dhe të kënaqshëm me kolegët	44	3	5	4.52	.664
Institucioni i kushton rëndësi dhe përdor me efikasitet ekspertizën profesionale të personelit akademik	44	2	5	4.00	.778
Institucioni ofron mbështetje për pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari akademike (konferenca shkencore, publikime në revista të rëndësishme, etj.)	44	2	5	4.16	.861
Institucioni siguron burime dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e kërkimit shkencor brenda institucionit	44	2	5	3.77	.831
U kushtohet rëndësi e mjaftueshme programeve të shkëmbimit për personelin	44	2	5	4.32	.800

akademik dhe studentët					
Institucioni u siguron studentëve akses të lehtë dhe të mjaftueshëm për komunikim me stafin akademik	44	2	5	4.43	.759
Jam i kënaqur me nivelin akademik dhe përkushtimin e studentëve në procesin e mësimdhënies	44	1	5	3.64	1.059
Valid N (listwise)	44				

Rezultati më i lartë lidhet me **bashkëpunimin konstruktiv me kolegët** ($M = 4.52$). Ky vlerësim tregon se marrëdhëniet profesionale ndërmjet stafit përbëjnë një pikë të fortë të mjedisit të punës në institucion.

Aksesi i studentëve në komunikim me stafin akademik vlerësohet gjithashtu shumë pozitivisht ($M = 4.43$). Kjo sugjeron se marrëdhënia pedagog–student dhe mundësitë për komunikim akademik janë të aksesueshme dhe funksionale.

Mbështetja administrative për përmbushjen e detyrave ($M = 4.32$), **efektiviteti i sekretarisë** ($M = 4.34$) dhe **mjaftueshmëria e personelit administrativ** ($M = 4.27$) marrin vlerësime të larta. Këto rezultate tregojnë se shërbimet administrative perceptohen si një mbështetje e dobishme për veprimtarinë akademike dhe organizative të stafit.

Në të njëjtin nivel pozitiv vlerësohen **atmosfera e përgjithshme e punës** ($M = 4.34$) dhe rëndësia që i kushtohet **programeve të shkëmbimit për stafin dhe studentët** ($M = 4.32$). Këta indikatorë pasqyrojnë një klimë pune përgjithësisht të favorshme dhe orientim institucional drejt mundësive të bashkëpunimit e ndërkombëtarizimit.

Mjedisi i punës dhe siguria për vazhdimësinë e angazhimit akademik vlerësohen me $M = 4.14$. Rezultati tregon një perceptim pozitiv për stabilitetin e marrëdhënies së punës, edhe pse ky mbetet një aspekt që lidhet natyrshëm me pritshmëritë profesionale afatgjata të stafit.

Mbështetja për pjesëmarrjen në konferenca, publikime dhe veprimtari të tjera akademike merr një vlerësim të mirë ($M = 4.16$). Edhe përdorimi i ekspertizës profesionale të stafit vlerësohet pozitivisht ($M = 4.00$), duke treguar se kontributi akademik i personelit njihet dhe përdoret në funksion të institucionit.

Dy indikatorët me mesatare më të moderuar janë **burimet dhe infrastruktura për zhvillimin e kërkimit shkencor** ($M = 3.77$) dhe **niveli akademik e përkushtimi i studentëve** ($M = 3.64$). Këto rezultate nuk tregojnë një vlerësim negativ, por *sugjerojnë se forcimi i mbështetjes për kërkimin shkencor dhe vijimi i punës për rritjen e angazhimit akademik të studentëve mund të jenë fusha me interes për zhvillim të mëtejshëm.*

Rezultatet e këtij seksioni evidentojnë një mjedis pune me marrëdhënie të mira profesionale, mbështetje administrative funksionale dhe komunikim të aksesueshëm me studentët. Në vijim, institucioni mund të konsolidojë më tej kushtet për kërkimin shkencor dhe mekanizmat që nxisin angazhimin akademik të studentëve.

IV. Vizioni dhe strategjia institucionale

Ky seksion paraqet perceptimin e stafit akademik për orientimin strategjik të institucionit, drejtimin e tij dhe mundësitë që ofron për zhvillim profesional afatgjatë. Vlerësimet janë të larta në të gjithë indikatorët, çka tregon një perceptim të qëndrueshëm pozitiv për identitetin dhe drejtimin institucional.

Tabela 6 Vlerësimi i stafit akademik për vizionin, drejtimin dhe perspektivën strategjike të institucionit

Descriptive Statistics					
	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation
Jam në dijeni për vizionin dhe misionin e institucioni	44	3	5	4.57	.625
Programet e studimit të ofruara nga institucioni përputhen me interesat dhe nevojat kombëtare	44	3	5	4.61	.618
Institucioni drejtohet me profesionalizëm dhe integritet	44	3	5	4.27	.660
Institucioni i kushton rëndësi të veçantë prezantimit kombëtar dhe ndërkombëtar	44	3	5	4.52	.628
E shoh UMT si një institucion të qëndrueshëm ku mund të zhvilloj karrierën time akademike	44	3	5	4.34	.680

afatgjatë					
E sugjeroj UMT si një mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e karrierës akademike	44	3	5	4.43	.661
Kushtet financiare të ofruara nga institucioni janë të kënaqshme	44	2	5	3.98	.792
Institucioni inkurajon përfshirjen e personelit akademik në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të tij afatgjata	44	2	5	4.20	.878
Valid N (listwise)	44				

Rezultati më i lartë lidhet me **përputhjen e programeve të studimit me interesat dhe nevojat kombëtare** ($M = 4.61$). Kjo tregon se stafi e vlerëson ofertën akademike të institucionit si të lidhur me kërkesat e mjedisit profesional dhe zhvillimet e vendit.

Njohja e **vizionit dhe misionit të institucionit** vlerësohet po ashtu shumë lart ($M = 4.57$). Rezultati sugjeron se orientimi bazë i institucionit është i komunikueshëm dhe i njohur për stafin akademik.

Rëndësia që i kushtohet prezantimit kombëtar dhe ndërkombëtar merr një vlerësim të lartë ($M = 4.52$). Kjo pasqyron perceptimin se institucioni synon të ruajë dhe të zhvillojë praninë e tij në mjedisin akademik e profesional, brenda dhe jashtë vendit.

Stafi vlerëson pozitivisht edhe mundësinë për ta parë **UMT-në si një institucion të qëndrueshëm për zhvillimin e karrierës akademike afatgjatë** ($M = 4.34$). Në të njëjtën linjë, gatishmëria për ta sugjeruar **UMT-në si mundësi për zhvillim të karrierës akademike** vlerësohet me $M = 4.43$. Këto dy rezultate tregojnë besim të mirë në perspektivën institucionale dhe në vlerën që institucioni ofron për stafin e tij.

Profesionalizmi dhe integriteti në drejtimin e institucionit vlerësohen me $M = 4.27$. Rezultati tregon se drejtimi institucional perceptohet pozitivisht dhe si i mbështetur në standarde profesionale.

Përfshirja e personelit akademik në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive afatgjata vlerësohet me $M = 4.20$. Ky rezultat tregon një perceptim pozitiv për hapësirat e konsultimit dhe pjesëmarrjes

së stafit në çështje strategjike.

Kushtet financiare të ofruara nga institucioni marrin mesataren më të moderuar të këtij seksioni ($M = 3.98$). *Vlerësimi mbetet pozitiv, por sugjeron se ky është një aspekt që mund të vazhdojë të vlerësohet në funksion të pritshmërive profesionale dhe zhvillimit afatgjatë të stafit.*

Vlerësimet e stafit tregojnë besim të lartë në vizionin, programet dhe perspektivën e institucionit. Komunikimi i vazhdueshëm i prioritetëve strategjike, përfshirja e stafit dhe vëmendja ndaj kushteve të angazhimit do të ndihmonin në ruajtjen e këtij perceptimi pozitiv.

Aspektet që i japin kënaqësi stafit akademik në punën në UMT

Përgjigjet e stafit akademik paraqesin një tablo përgjithësisht pozitive për përvojën e punës në UMT. Tema që shfaqet më shpesh është *mjedisi i punës dhe marrëdhëniet me kolegët*. Pjesëmarrësit vlerësojnë klimën bashkëpunuese, frymën jo toksike, komunikimin e mirë profesional dhe mbështetjen e ndërsjellë në veprimtarinë e përditshme akademike. Kjo përputhet edhe me rezultatet sasiore, ku bashkëpunimi me kolegët mori vlerësimin më të lartë në këtë dimension.

Një element tjetër i rëndësishëm është *puna me studentët dhe mundësia për të kontribuar në formimin e tyre akademik e profesional*. Disa prej stafit e lidhin kënaqësinë në punë me mësimdhënien, me ndarjen e njohurive, me nxitjen e mendimit kritik dhe me mbështetjen e studentëve në zhvillimin e tyre të mëtejshëm.

Përgjigjet e stafit evidentojnë gjithashtu *lirinë dhe pavarësinë akademike*, fleksibilitetin në organizimin e detyrave dhe përputhjen ndërmjet profilit profesional të stafit dhe angazhimeve që kryejnë në institucion. Këto elemente perceptohen si të rëndësishme për ruajtjen e motivimit dhe të përgjegjësisë profesionale.

Një pjesë e pjesëmarrësve vlerëson mundësitë për *zhvillim profesional dhe kërkim shkencor*, përfshirë angazhimin në projekte, konferenca, bashkëpunime kombëtare e ndërkombëtare dhe përditësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së mësimdhënies. Po ashtu, përmenden pozitivisht transparenca në vendimmarrje, orientimi drejt cilësisë dhe përpjekjet institucionale për përmirësim të vazhdueshëm.

Në tërësi, komentet sugjerojnë se kënaqësia e stafit lidhet kryesisht me cilësinë e marrëdhënieve profesionale, mjedisin akademik, autonominë në punë dhe mundësinë për të pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e studentëve dhe të institucionit.

Sugjerime të stafit për zhvillimin e mëtejshëm të mjedisit akademik dhe institucional

Përgjigjet e hapura ofrojnë disa orientime të dobishme për vijimin e përmirësimit të përvojës profesionale të stafit akademik në UMT. Edhe pse të njëjtat tema vlerësohen si elemente që japin kënaqësi në punën në UMT, në disa raste, një pjesë e sugjerimeve lidhet me zgjerimin e mundësive për zhvillim profesional, kërkim shkencor, pjesëmarrje në konferenca, projekte dhe bashkëpunime kombëtare e ndërkombëtare. Këto kërkesa pasqyrojnë interesin e stafit për t'u angazhuar më tej në veprimtari që forcojnë profilin akademik të institucionit.

Një grup tjetër sugjerimesh i referohet vijimit të përmirësimit të proceseve të brendshme, përmes komunikimit të rregullt të procedurave, digjitalizimit gradual të shërbimeve dhe qartësimit të roleve e afateve në disa procese administrative. Këto elemente synojnë rritjen e funksionalitetit dhe lehtësimin e punës së përditshme të stafit.

Disa pjesëmarrës nënvizojnë rëndësinë e ruajtjes së një klime profesionale bashkëpunuese, të bazuar në komunikim, respekt të ndërsjellë dhe vlerësim të kontributit individual. Në të njëjtën linjë, përmenden mundësitë për forcimin e mëtejshëm të konsultimit me stafin, të mbështetjes për iniciativat akademike dhe të aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin ndërmjet kolegëve.

Përgjigjet tregojnë gjithashtu se motivimi dhe qëndrueshmëria profesionale lidhen me mundësitë për rritje akademike, angazhim në projekte, njohje të kontributit dhe zhvillim të vazhdueshëm të kompetencave. Një pjesë e pjesëmarrësve kanë shprehur kënaqësi me përvojën e tyre aktuale në institucion, ndërsa sugjerimet e dhëna mund të shërbejnë si orientim për konsolidimin e mëtejshëm të mjedisit akademik dhe institucional.

Përfundime

Vlerësimi i realizuar nga personeli akademik për vitin akademik 2025–2026 paraqet një perceptim përgjithësisht pozitiv për funksionimin e Universitetit Metropolitan Tirana dhe për kushtet që institucioni krijon për zhvillimin e veprimtarisë akademike. Rezultatet e pyetësorit, të plotësuara nga komentet e hapura të stafit, tregojnë se UMT vlerësohet si një mjedis pune me marrëdhënie profesionale bashkëpunuese, orientim të qartë institucional dhe hapësira të përshtatshme për angazhim akademik e zhvillim profesional.

Në dimensionin e infrastrukturës, stafi vlerëson veçanërisht sigurinë fizike, numrin e përshtatshëm të studentëve në klasa, pastërtinë dhe mirëmbajtjen e mjediseve, si edhe funksionalitetin e infrastrukturës teknologjike. Këto rezultate dëshmojnë se institucioni ofron kushte të qëndrueshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe të punës së përditshme akademike.

Sa i përket rolit dhe angazhimit të personelit akademik, vlerësimet e larta për qartësinë e detyrave, përputhjen e tyre me profilin akademik, respektimin e kushteve të angazhimit dhe transparencën e vlerësimit të performancës tregojnë se marrëdhënia profesionale ndërmjet stafit dhe institucionit mbështetet në kritere të qarta dhe në përgjegjësi të përcaktuara. Liria akademike dhe hapësira për shprehjen e mendimeve profesionale vlerësohen gjithashtu pozitivisht.

Një nga rezultatet më të rëndësishme të raportit lidhet me klimën e punës dhe marrëdhëniet ndërmjet kolegëve. Bashkëpunimi konstruktiv ndërmjet stafit merr vlerësimin më të lartë në dimensionin e shërbimeve dhe mbështetjes akademike, ndërsa komentet e hapura e përforcojnë këtë gjetje duke evidentuar rëndësinë e mjedisit bashkëpunues, komunikimit profesional dhe mbështetjes së ndërsjellë. Mbështetja administrative, efektiviteti i sekretarisë dhe aksesit i studentëve në komunikim me stafin akademik përbëjnë gjithashtu elemente të vlerësuara pozitivisht.

Stafi shpreh besim të lartë në orientimin strategjik të UMT-së. Programet e studimit perceptohen si të lidhura me nevojat kombëtare, vizioni dhe misioni institucional janë të njohura, ndërsa prezantimi kombëtar dhe ndërkombëtar i institucionit vlerësohet pozitivisht. Gatishmëria e stafit për ta sugjeruar UMT-në si mjedis për zhvillimin e karrierës akademike dhe perceptimi i institucionit si hapësirë e qëndrueshme për angazhim afatgjatë dëshmojnë për një nivel të mirë besimi në perspektivën e tij.

Rezultatet sugjerojnë gjithashtu disa drejtime që mund të mbeten në vëmendje në vijim, veçanërisht forcimi gradual i mbështetjes për kërkimin shkencor, zhvillimi i mëtejshëm i mundësive për angazhim në projekte dhe veprimtari akademike, si edhe ruajtja e një balance të përshtatshme ndërmjet mësimdhënies, kërkimit, angazhimeve administrative dhe zhvillimit profesional. Vëmendje e vazhdueshme mund t'i kushtohet edhe përmirësimit të mëtejshëm të hapësirave të punës dhe shërbimeve mbështetëse për stafin.

Komentet e hapura dëshmojnë një interes të qartë të stafit për të kontribuar në zhvillimin e institucionit. Sugjerimet e dhëna lidhen kryesisht me zgjerimin e mundësive për kërkim shkencor, zhvillim profesional, bashkëpunime akademike dhe përmirësim të vazhdueshëm të proceseve të brendshme. Këto orientime përbëjnë një bazë të dobishme për planifikimin e masave të ardhshme në funksion të konsolidimit të cilësisë institucionale.

Rezultatet e këtij vlerësimi do të shërbejnë si bazë për reflektim nga strukturat drejtuese dhe njësitë përkatëse të UMT-së, me synim ruajtjen e elementeve që vlerësohen pozitivisht dhe zhvillimin gradual të atyre aspekteve që mund të forcohen më tej.

**UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA
PYETËSOR PËR VLERËSIMIN E INSTITUCIONIT NGA ANËTARËT E
PERSONELIT AKADEMIK**

I nderuar anëtar i personelit akademik,

Ky pyetësor synon të ofrojë një hapësirë për të shprehur vlerësimin tuaj mbi përvojën në Universitetin Metropolitar Tirana (UMT), duke na ndihmuar të identifikojmë fushat ku mund të përmirësojmë më tej mbështetjen dhe zhvillimin profesional për stafin tonë akademik.

Rezultatet e këtij pyetësi do të shërbejnë për të nxitur një mjedis akademik që reflekton standardet dhe aspiratat e larta të institucionit tonë. Përgjigjet tuaja do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe do të ndihmojnë në zhvillimin e një vizioni më të qartë për përmirësimin e përvojës së përbashkët në UMT.

Ju falënderojmë për kohën, sinjeritetin dhe angazhimin tuaj të vazhdueshëm në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit në institucionin tonë!

Kategoria së cilës i përkisni

- A. Profesor
- B. Lektor
- C. Asistent lektor

Eksperienca e punës

- A. 1-5 vjet
- B. 6-10 vjet
- C. 11-15 vjet
- D. 16-20 vjet
- E. Mbi 20 vjet

Vlerësoni pohimet e mëposhtme sipas shkallës nga 1 në 5, ku 1 është vlerësim minimal dhe 5 maksimal, respektivisht nga “Nuk jam aspak dakord” deri në “Jam plotësisht dakord”.

<i>Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit</i>						
Nr.	Pohimi	Vlerësimi				
1	Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës	1	2	3	4	5
2	Jam i kënaqur me nivelin e sigurisë fizike dhe të mbrojtjes që institucioni ofron	1	2	3	4	5
3	Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë e ofruar në institucion janë në nivelin e duhur	1	2	3	4	5
4	Hapësira që kam në vendin e punës dhe mësimdhënies është e mjaftueshme dhe motivuese për punë efektive	1	2	3	4	5
5	Institucioni ofron një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore (si projektorë, kompjuterë, rrjet interneti, sistem i menaxhimit të informacionit) që	1	2	3	4	5

	lehtëson mësimdhënien dhe kërkimin					
6	Numri i studentëve në klasa lejon zhvillimin normal dhe efektiv të mësimi	1	2	3	4	5
7	Institucioni ofron mundësi të përshtatshme për shërbime sociale (si kafene, ngrënie e drekës, mjedise sportive etj.) që lehtësojnë komoditetin dhe mirëqenien gjatë orarit të punës	1	2	3	4	5
<i>Roli dhe të drejtat e personelit akademik në institucion</i>						
8	Kam përshkrim të qartë të detyrave që më përkasin	1	2	3	4	5
9	Institucioni respekton kushtet kontraktuale lidhur me angazhimin tim	1	2	3	4	5
10	Procedurat për adresimin e ankesave janë të aksesueshme	1	2	3	4	5
11	Procesi i vlerësimit të performancës akademike është i qartë, transparent dhe i bazuar në kriteret objektive	1	2	3	4	5
12	Personeli akademik gëzon liri në shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tij	1	2	3	4	5
13	Institucioni mbështet dhe inkurajon idetë dhe kontributet e reja nga personeli akademik	1	2	3	4	5
14	Institucioni nxit përfshirjen e personelit akademik në proceset vendimmarrëse	1	2	3	4	5
15	Detyrat e mia janë në përputhje me fushën time akademike	1	2	3	4	5
16	Jam i kënaqur me balancën ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit	1	2	3	4	5
17	Përfshirja ime në detyra administrative ndikon në kohën dhe energjinë që mund t'i përkushtoj angazhimeve akademike	1	2	3	4	5
<i>Shërbimet dhe mbështetja akademike e institucionit</i>						
18	Institucioni më ofron mbështetjen administrative të nevojshme për përmbushjen e detyrave të mia	1	2	3	4	5
19	Numri i personelit administrativ është i mjaftueshëm për të mbështetur nevojat e institucionit	1	2	3	4	5
20	Jam i kënaqur me efektivitetin e punës së sekretarisë së njësive përkatëse	1	2	3	4	5
21	Institucioni ofron një mjedis pune të qëndrueshëm dhe siguri për vazhdimësinë e angazhimit tim akademik	1	2	3	4	5
22	Jam i kënaqur me atmosferën e përgjithshme të punës në institucion	1	2	3	4	5
23	Kam një bashkëpunim konstruktiv dhe të kënaqshëm me kolegët	1	2	3	4	5
24	Institucioni i kushton rëndësi dhe përdor me efikasitet ekspertizën profesionale të personelit	1	2	3	4	5

	akademik					
25	Institucioni ofron mbështetje për pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari akademike (konferenca shkencore, publikime në revista të rëndësishme, etj.)	1	2	3	4	5
26	Institucioni siguron burime dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e kërkimit shkencor brenda institucionit	1	2	3	4	5
27	U kushtohet rëndësi e mjaftueshme programeve të shkëmbimit për personelin akademik dhe studentët	1	2	3	4	5
28	Institucioni u siguron studentëve akses të lehtë dhe të mjaftueshëm për komunikim me stafin akademik	1	2	3	4	5
29	Jam i kënaqur me nivelin akademik dhe përkushtimin e studentëve në procesin e mësimdhënies	1	2	3	4	5
<i>Vizioni dhe strategjia institucionale</i>						
30	Jam në dijeni për vizionin dhe misionin e institucionit	1	2	3	4	5
31	Programet e studimit të ofruara nga institucioni përputhen me interesat dhe nevojat kombëtare	1	2	3	4	5
32	Institucioni drejtohet me profesionalizëm dhe integritet	1	2	3	4	5
33	Institucioni i kushton rëndësi të veçantë prezantimit kombëtar dhe ndërkombëtar	1	2	3	4	5
34	E shoh UMT si një institucion të qëndrueshëm ku mund të zhvilloj karrierën time akademike afatgjatë	1	2	3	4	5
35	E sugjeroj UMT si një mundësi të shkëlqyer për zhvillimin e karrierës akademike	1	2	3	4	5
36	Kushtet financiare të ofruara nga institucioni janë të kënaqshme	1	2	3	4	5
37	Institucioni inkurajon përfshirjen e personelit akademik në zhvillimin dhe përmirësimin e strategjive të tij afatgjata	1	2	3	4	5

1. Rendisni disa nga aspektet kryesore në UMT që ju japin kënaqësi në punën tuaj

2. Përmendni disa elemente që, sipas mendimit tuaj, do të ndihmonin në rritjen e motivimit tuaj në UMT



- 3. Rendisni një ose disa faktorë që mund t'ju motivojnë për të kërkuar mundësi të reja karriere jashtë UMT.**

- 4. Sugjeroni çfarë mund të ndryshohet ose përmirësohet për të arritur një administrim më të mirë në UMT.**
